



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2563, datë 11.05.2015

**“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albanian Mobile Communications”
sh.a. për katër të drejta përdorimi nga 2x5 MHz spekter i çiftuar në brezin e
frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 11.05.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albanian Mobile Communications”
sh.a. për katër të drejta përdorimi nga 2x5 MHz spekter i çiftuar në brezin e
frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS.**

BAZA LIGJORE:

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”);
3. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

4. Vendimi Nr. 1252, datë 10.9.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave” i ndryshuar,
5. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395, datë 15.12.2013.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.2559, datë 27.04.2015 për “Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS*”, Ref. 14-2x5-10x5-2015.
7. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave te pagesave të kryera nga sipërmarrësi “Albanian Mobile Communications” sh.a.
 - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
 - si dhe,
- duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

V Ë R E N :

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr.2559, datë 27.04.2015, në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt “**Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS**”, Ref. 14-2x5-10x5-2015 miratoi:
 - a) Raportin Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në të cilin oferta e sipërmarrësit “Albanian Mobile Communications” sh.a. identifikohet si ofertë fituese.
 - b) Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 16 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr. 810/6 Prot., datë 27.04.2015 i ka dërguar “Albanian Mobile Communications” sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.810/5 Prot., datë 27.04.2015, sipas Shtojca 16, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. “Albanian Mobile Communications” sh.a. brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:
 - a) Çmimin e ofertës me shumën **3.020.634 (tremilion e njëzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) Euro**, më datë 30.04.2015, në Logarinë bankare me emërtim: *Qeveria Shqiptare*.

1. Pagesen vjetore (për 8 muaj) **1.920.000 (një milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë** për përdorimin e katër të drejtave të përdorimit nga 2x5 MHz të frekuencave të brezit 2500-2690 MHz.
2. Pagesen vjetore (për 8 muaj) **6.914.880 (gjashtë milion e nëntëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë** për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për te drejtat e përdorimit 2x5 MHz të frekuencave të brezit 2500-2690 MHz.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL30214112090 111113869030117.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për ”Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115 ,
3. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
4. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008, i ndryshuar,
5. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin “Albanian Mobile Communications” sh.a. me Autorizim Individual për përdorimin e katër të drejta përdorimi nga 2x5 MHz (2x20 MHz) spekter i çiftuar në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Sipërmarrësi do të shfytëzojë frekuencat e dhëna nëpërmjet procedurës së tenderit publik me objekt **“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015**, në përputhje me kushtet e pranuar të Dokumentit të Tenderit.
3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për katër të drejta përdorimi nga 2x5 MHz spekter i çiftuar në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS të fituara nëpërmjet tenderit me objekt **“Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave**

2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”, Ref. 14-2x5-10x5-2015 do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, nga 01.05.2015 deri në 01.05.2030.

4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____